



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk II.nr. 1278/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri në çështjen përmbarimore të kreditorit “Sinani-ing” sh.p.k, me NUI:810199039, me seli në Prishtinë, Lagja Ulpiana Rr. “Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat S.M. nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (ARDP), me seli në Prishtinë, Rr. “Ukshin Hoti”-Kompleksi “Ramiz Sadiku”, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.1357/22 të datës 30.05.2023, me datë 18.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (ARDP), ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.1357/22 të datës 30.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1357/22 të datës 30.05.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (ARDP), sa i përket pjesës së detyrimit në shumën prej 15,857.10 €, në këtë pjesë Urdhri i Përmbaruesit privat Myjesere Mujku P.nr.111/2021 të datës 30.06.2021, shfuqizohet. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (ARDP), sa i përket pjesës së mbetur të detyrimit

në shumën 15,656.75 €, në këtë pjesë Urdhri i Përmbauesit Privat Myjesere Mujku P.nr.111/2021 të datës 30.06.2021, mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, PPP.nr.1357/22 të datës 30.05.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Sinani-ing” sh.p.k, ka paraqitur propozim për përmbaimit mbi bazën e dokumentit të besueshëm – Faturës nr.008/21 të datës 23.02.2021, faturë kjo e lëshuar në emër të realizimit të punimeve sipas situacionit të bashkangjitur, duke e detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga fatura e lartcekur, t’ia paguan kreditorit shumën totale prej 31,513.85€, me kamatë prej 8 % duke llogaritur nga data kur debitori e ka pranuar faturën e cila është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore të bëhen në përputhje me Rregulloren për Tarifa të OAK-ut në shumën prej 312.00 €.

Përmbauesi Privat Myjsere Mujku me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaimit të kreditorit me urdhrin përmbaimit P.nr.111/2021 të datës 30.06.2021, e ka lejuar përmbaimitin e propozuar nga kreditori.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit përmes parashtrësës së datës 15.07.2021 ka bërë precizimin e borxhit të lartcekur, duke theksuar se debitori i është përgjigjur pretendimeve të kreditorit duke paguar shumën prej 15,857.10 € në llogari të kreditorit me datën 15.07.2021, dhe duke mbetur

borxh për shumën prej 15,656.75 €, andaj, ka propozuar që Përmbaruesi Privat të vazhdojë procedurën kundër debitorit për shumën e mbetur të borxhit prej 15,656.75 €, me kamatë prej 8 % duke llogaritur nga data kur debitori e ka pranuar faturën e cila është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, për pagesën e shumës prej 312.00 € në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, dhe shumën 312.00 € në emër të përpilimit të parashtresës për precizimin e borxhit, si dhe të bëjë pagesën e shpenzimeve përmbarimore të përmbaruesit aq sa do të krijohen deri në pagesën definitive.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor si të pa bazuar, duke theksuar se ky propozim për përmbarim nuk i plotëson kushtet si dokument ekzekutues-përmbarues në pajtim me dispozitat nga neni 21 dhe 22 par.1 pika 1.12, neni 24 par.1 dhe 3, si dhe neni 27 par.1 të LPP-së, pasi që nga i njëjti nuk mund të përcaktohet shuma konkrete dhe mjetet e përmbarimit, nuk dihet koha e përmbushjes së detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, andaj, i njëjti është i pa përmbarueshëm-pa përballueshëm dhe në këtë drejtim rezultojnë si të bazuara, të themelta dhe të qëndrueshme kundërshtimet e palës debitore. Tutje ka theksuar se kreditori me parashtresën e datës 15.07.2021 ka bërë precizimin e borxhit, duke konstatuar se debitori i është përgjigjur pretendimeve të kreditorit duke paguar shumën prej 15,857.10 € në llogari të kreditorit me datën 15.07.2021, por ka mbetur borxh në shumën prej 15,656.75 €, andaj, debitori duke u bazuar në propozimet e Përmbaruesit Privat të cilat janë kundërthënëse dhe të pa precizuara me kohë, i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë si të pa bazuar propozimin për përmbarim të kreditorit të ushtruar përmes Përmbaruesit Privat Myjesere Mujku, nga Prishtina, sipas Urdhrit P.nr.111/2021 të datës 30.06.2021, në shumën prej 31,513.85 €.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazë, duke theksuar se debitori e ka konfirmuar atë që është thënë në propozim për përmbarim dhe parashtresën për precizimin e propozimit të përmbarimit të dërguar tek Përmbaruesi Privat, me të cilën e ka njoftuar organin përmbarimor se debitori i është përgjigjur pretendimeve të kreditorit duke paguar shumën prej 15,857.10 € në llogari të kreditorit me datën 15.07.2021, dhe duke mbetur borxh në shumën prej 15,656.75 €. Tutje ka theksuar se debitori qëllimisht i është referuar gabim dispozitave ligjore përmes të cilave pretendon se propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet si dokument ekzekutues/përmbarues, ngase shihet qartë se debitori me anë të këtij prapësimi ka pasur vetëm një qëllim, dhe atë vonesat edhe të

mëtejshme të pagesës së kreditorit. Po ashtu, ka theksuar se kreditori propozimin për përbarim e ka parashtruar në bazë të nenit 29 par.1 pika 1.3 lidhur me nenin 40 të LPP-së, dhe i njëjti nuk ka arsye objektive që të refuzohet si i pa bazuar, ngase i plotëson të gjitha kriteret e parapara me LPP. Andaj, ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si të pa bazuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1357/22 të datës 30.05.2023, ku në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (ARDP), sa i përket pjesës së detyrimit në shumën prej 15,857.10 €, në këtë pjesë Urdhri i Përmbauesit privat Myjesere Mujku P.nr.111/2021 të datës 30.06.2021, shfuqizohet. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (ARDP), sa i përket pjesës së mbetur të detyrimit në shumën 15,656.75 €, në këtë pjesë Urdhri i Përmbauesit Privat Myjesere Mujku P.nr.111/2021 të datës 30.06.2021, mbetet në fuqi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës Urdhri përbarimor P.nr.111/2021 i datës 30.06.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës nr.008/21 të datës 23.02.2021, ngase debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin në shumën prej 15,857.10 €, duke mbetur borxh shumën prej 15,656.75 €, të cilin fakt e ka konfirmuar edhe kreditori me parashtrësën për precizimin e borxhit, si dhe debitori në prapësim e paraqitur kundër urdhrin të lartcekur, i cili ka theksuar se debitori i është përgjigjur pretendimeve të kreditorit duke paguar prej 15,857.10 €, dhe ka mbetur borxh në shumën prej 15,656.75 €. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.111/2021 të datës 30.06.2021 për shumën në vlerë prej 15,656.75 €, për faktin se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përbarimor për pjesën e borxhit prej 15,857.10€, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate

me shikim nga shkresat e lëndës konstatohet se debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin në shumën prej 15,857.10€, fakt të cilin e kanë konfirmuar kreditori nëpërmjet parashtresës për precizimin e borxhit si dhe debitori në prapësimin e paraqitur kundër udhrit përmbarimor. Andaj, fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri përmbarimor e ka humbur pjesërisht efektin sepse e njëjta është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në kuptim të nenit 71 par1 nëpar.1.2 të LPP-së me të cilin parashihet se “ *dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik*”.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se sa i përket pikës II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa ka lejuar urdhrin përmbarimor në shumën prej 15,656.75 € ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve të kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit kur ka theksuar se nga dokumenti i besueshëm-fatura nr.008/21 të datës 23.02.2021 nuk mund të përcaktohet shuma konkrete dhe mjetet e përmbarimit, nuk dihet koha e përmbushjes së detyrimit por të njëjtat mbasin të pabazuara pasi që bazuar nga shkresat e lëndës kjo gjykatë vlerëson se procedura përmbarimore është inicuar ndaj dokumentit të besueshëm-faturës së lartcekur e cila plotëson të gjitha kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm në pajtim me nenin 29 par.1 të LPP-së. Kjo gjykatë rithekson se një pjesë e detyrimit që buron nga fatura në shumën prej 15,857.10 € është përmbushur ndërsa debitori ka

mbetur në detyrim në shumën e mbetur prej 15,656.75 € nga po e njëjta faturë e cila është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, për këtë arsye aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit, për faktin se nga shkresat e lëndës respektivisht vërtetohet se fatura si dokument i besueshëm, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi është e nënshkruar dhe e pranuar nga ana e debitorit me të gjitha të dhënat të përshkruar në faturë dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar me kohë, andaj fatura përmbanë edhe kohën e përmbushjës së detyrimit dhe rrjedhimisht e njëjta mund të konsiderohet si dokument i besueshëm për përmbarim në kuptim të dispozitës së nenit 29 dhe 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1278/23 me datë 18.03.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija- Ymeri